



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Data 30.08.2023

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e aksit rrugor Thumanë - Vorë – Kashar”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimit

VLERA E FONDIT LIMIT: 235’431’048.35 (dyqind e tridhjetë e pesë milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e dyzet e tetë pikë tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në të cilën parashikohet shprehimisht që : “Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”, autoriteti/enti kontraktor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sqaron se kjo procedurë prokurimi nuk është e ndarë në lote për arsye se shërbimi i inxhinierit të pavarur është një shërbim mbikëqyrje për një kontratë koncesionare e cila është një kontratë e vetme dhe nuk është e ndarë në lote.